

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM, DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin individual Ilir Bytyqi si dhe me sekretaren juridike Gentiana Jashari, në lëndën penale kundër të akuzuarit I.G., për shkak të veprës penale raste te posaçme te falsifikimit te dokumenteve nga neni 399 par. 1 pika 1.5 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.II. nr.1120-6/16 e datës 18.10.2016, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Burim Çerkini, të akuzuarit I.G. dhe mbrojtësit tij me autorizim Av. R.Sh., pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, me datat 16.11.2016, mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 21.11.2016 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: I.G., data e lindjes....., me vendbanim në fshatin K. Shtime, nga i ati B. dhe e ëma E. e gjinisë G., i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal

ËSHTË FAJTOR

Më datë 15.06.2016, rreth orës 11:30 në Shime. me rastin e kontrollit nga ana e Policisë është hasur duke drejtuar automjetin e markës “Renault Megane”, ngjyrë hiri, me nr. të shasisë:, në të cilin automjet pa autorizim kishte vendosur targat e regjistrimit me nr., të cilat targa ishin të automjetit - minibus të markës “Tyota”, ngjyrë hiri, pasi që vetura “Renault Megane” nuk i kishte të kryera obligimet doganore.

me të cilën ka kryer veprën penale rast te posaçme të falsifikimit të dokumenteve nga neni 399 par. 1 pika 1.5 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 399 par. 1 pika 1,1 të KPRK-së, si dhe neneve 7,17,41,42,43,46,69,73, të KPRK-së, nenit 233 dhe nenit 365 të KPPK-ës, të akuzuarin e,

G J Y K O N
D E N I M M E G J O B E

- **Të akuzuarin I.G., gjykon me dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro) €, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.**
- **Nëse dënimi i shqiptuar si më lart nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nenin 46 par. 3 të KPRK-së, i njejti do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 Euro i pandehuri do të vuaj 1 /një/ ditë burgim.**
- **Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20 Euro, në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.**
- **Konfom nenit 115 par. 2 pika 2.1, sekuestrohen në mënyrë të përhershme targat e regjistrimit**

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka paraqitur aktakuzën PP.II.1120-6/16 të datës 18.10.2016, ndaj të akuzuarit I.G., për shkak të veprës penale raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve nga neni 399 par. 1 pika 1.5 të KPRK-së.

Prokuroria e shtetit aktakuzës i ka bashkangjitur Marrëveshjen për pranimin e fajësisë të datës 04.10.2016, deklaratën e të pandehurit I.G. të datës 04.10.2016 të nënshkruar nga ana e të pandehurit, mbrojtësit të tij Av. R.Sh., prokurori i shtetit Bahri Hyseni dhe kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj Agron Qalaj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze me datën 16.11.2016 ka mbajtur seancën për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë të arritur me datës 04.10.2016, në të cilën i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit u deklaruan përkitazi me marrëveshjen e pranimin të fajësisë duke i propozuar gjykatës pranimin e kësaj marrëveshje sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje.

Gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara sipas dispozitës së nenit 233 par. 18 të KPPK-së, se:

- I akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë,
- Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe se i akuzuari nuk kanë qenë i detyruar e as i shtrënguar në asnjë mënyrë që ta pranojë fajësinë,
- Pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe materialet e prezantuara nga prokurori dhe atë: vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve i dt. 15.06.2016, vërtetimi mbi dorzimin e veturës Doganes të Kosoves dt. 15.06.2016, tabelat e regjistrimit, deklaratat e të pandehurit në hetuesi dt. 28.06.2016, deklaratat e dt. 04.10.2016, si dhe fotografitë dhe shkresat tjera të lëndës, të gjitha këto prova të siguruara gjatë procedurës hetimore.
- Si dhe nuk ekzistonë asnjë rrethanë e paraparë nga neni 253 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Andaj, gjykata e pranoi marrëveshjet për pranimin e fajësisë dhe bazuar në këtë marrëveshje vazhdoi me shqiptimin e dënimit për të akuzuarit.

Gjykata duke vlerësuar aspektin juridik gjeti se në veprimet e të akuzuarit I.G. ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve nga neni 399 par. 1 pika 1.5 të KPRK-së, meqë me datë, kohë dhe vend siq është përcaktuar në dispozitivin të këtij aktgjykimi, i akuzuari ka falsifikuar targat e regjistrimit të automjetit, në kundërshtim me nenin 399 par. 1 pika 1.5 të KPRK-së, të vërtetuar gjendjen e fakteve si ne vijim, i akuzuari me rastin e kontrollit nga ana e policisë është hasur duke drejtuar automjetin “Renault Megane” ngjyre hiri, me numër të shasisë, në të cilin automjet pa autorizim kishte vendosur targat e automjetit minibus “Toyota”, pasi që vetura Renault Megane” nuk i kishte të kryera obligimet doganore.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori se

kanë arritur marrëveshje për pranimitë fajësisë, sjelljen e tije korrekte gjatë procedurës penale, nuk ka dëshmi se i pandehuri ka qene i dënuar me pare me vendim te formës se prerë, ndersa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale dhe bazuar në faktin se i pandehuri ka arritur marrëveshje për pranimitë e fajësisë, gjykata beson që me dënimet e shqiptuar do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i përcaktuar me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprave penale, rrethanave të kryerjesë së veprave penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-së, që në emër të paushallit gjyqësor obligohet i pandehuri paushallin gjyqësor në shumën prej 20 /njëzet/ euro, në afat prej 15 ditëve nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nënë kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Nga arsyet e lartë cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, P.nr.998/16 të dt. 21.11.2016

Sek. Juridike
Gentiana Jashari

Gjyqtari Individual
Ilir BYTYQI

KËSHILLA JURIDIKE – kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.